



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 18.12.2023

Nr: 193

Ora: 11:00

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 95/1, DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI “PARTIA E LIRISË” DHE PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 95/2, DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI “PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 18.12.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:**

Koalicioni “Bashkë Fitojmë

Subjekti zgjedhor “Partia e Lirisë”

Subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”

**OBJEKT:**

Ankim kundër vendimit të “KQZ” rrëzimin e kërkesës së Koalicionit “Bashkë Fitojmë” për të shpallur të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, z. Kreshnik

Data: 18.12.2023 Nr: 193  
Ora: 11:00



“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 95/1, depozituar nga “Partia e Lirisë” dhe për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 95/2 depozituar nga “Partia Demokratike”

Hajdari. Ky vendim i njoftohet menjëherë Kryeministrit për të vijuar më procedurat e parashikuara nga neni 115 i Kushtetutës.” Në lidhje me shqyrtimin e projektvendimit “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues z. Kreshnik Riza Hajdari, Kryetar i Bashkisë Kuçovë, Qarku Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, datë 14 nëntor 2023, ora 12:00, Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve.

**BAZË LIGJORE:**

Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

**VËREN:**

Subjeti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 95 regj., datë 16.11.2023.

Në mbledhjen e datës 23.11.2023, ora 11:00, pas relativitetit të çështjes objekt shqyrtimi u konstatua se kërkesa ankimore nuk i plotësonte elementet e formës të parashikuara në nenin 126, pasi është paraqitur me të meta. Konkretisht ankimi duhet të depozitohet nga subjekti zgjedhor që ka interes të ligjshëm, pasi me certifikimin e rezultatit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, koalicionit i ka përfunduar personaliteti juridik.

Trupa e KAS me unanimitet vendosi kthimin e kërkesës ankimore nr. 95, datë 16.11.2023, për plotësim të elementëve të formës brenda 24 orëve nga shpallja e këtij vendimi, për shkak se afati i ankimit ndaj vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve përfundonte më datën 14.12.2023.

Në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në vendimin nr. 191, datë 23.11.2023, në protokollin e KQZ janë administruar dy shkresa:

- Nr. 7722 prot., datë 24.11.2023, me ankues “Partia e Lirisë”, përfaqësuar nga nënkryetari z. Endrit Braimllari, regjistruar me nr. KA 95/1, vijimësi e KA nr. 95;

Data: 18.12.2023 Nr: 193  
Ora: 11:00



“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 95/1, depozituar nga “Partia e Lirisë” dhe për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 95/2 depozituar nga “Partia Demokratike”

- Nr. 7724 prot., datë 24.11.2023, me ankues “Partia Demokratike e Shqipërisë”, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Flamur Noka, regjistruar me nr. KA 95/2, vijimësi e KA nr. 95.

Në mbledhjen e datës 18.12.2023, pas relativitetit të z. Elvin Lako, u konstatua se kërkesa ankimore regjistruar me nr. 95/1, depozituar nga subjekti zgjedhor “Partia e Lirisë”, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Në lidhje me kërkesën ankimore regjistruar me nr. 95/2, depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”, në mbledhjen e datës 18.12.2023 z. Elvin Lako relatori i çështjes objekt shqyrtimi, konstaton se “Partia Demokratike e Shqipërisë”, nuk ka qënë pjesë e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, si dhe nuk ka qënë iniciator në këtë procedurë.

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronjat “a” dhe “b”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe nenit 129 pika 3 shkronja “b” të Kodit Zgjedhor kërkesa ankimore regjistruar me nr. 95/2, me ankues subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”, nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

#### **V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 95/1, depozituar nga z. Endrit Braimllari.
2. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 95/2, depozituar nga z. Flamur Noka.
3. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 5.1.2024, ora 10:30.

Data: 18.12.2023 Nr: 193  
Ora: 11:00



“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 95/1, depozituar nga “Partia e Lirisë” dhe për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 95/2 depozituar nga “Partia Demokratike”

4. Për pikën 2 të dispozitivit, ankimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë 18.12.2023.

<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar (Pjesërisht kundër)</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>